

# NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. PETRIT

## ÇENO

02/27/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 25.02.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Çeno, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 27.02.2019 vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Petrit Çeno, kryetar i Gjykatës së Apelit Civil Durrës.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga z. Lulzim Hamitaj, znj. Etleda Çiftja relatore, z. Olsi Komici anëtar, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve

.

Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.